



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 64, datë 17.03.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E DISA SHTESAVE NË ANEK SIN 1 BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 118, DATË 27.10.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 5, RRUGA “DAVID SELENICA”, PALLATI NR. 18, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.164, datë 19.2.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, i ndryshuar; Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022; Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar; Raportit me nr. 2596/1 prot. datë 10.03.2023 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e disa shtesave në Aneksin 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 118, datë 27.10.2022, përsa i përket listës së përfituesve për pallatin nr.18, rruga “David Selenica”, në Njësinë Administrative nr.5, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT, QË DO PËRFITOHET
8	ASTRIT VELAJ, BEHARE VELAJ	5	3+1
9	KRISTAQ TAPIA	2	1+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 21.03.2023**



28/3/23 2702/4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 201/prot.  
3

Durrës, më 27.03.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.64 datë 17.03.2023 “Për miratimin e disa shtesave në aneksin 1 bashkëlidhur VKB Nr 118 dt 27.10.2022, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Nr 5, Rruga “David Selenica” Pall nr 18, i dëmtuar nga fatkeqësia e tërmetit të datës 26.11..2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

